



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:229725
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05450735

C.nr.66/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurit M.M nga Vushtrria, rruga ... me objekt kontesti Rimbursim dëmi, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia 66/18 e datës 16.02.2018, e paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurit M.M nga Vushtrria, rruga ... me objekt kontesti Rimbursim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësja B... me seli në Prishtinë, rruga ... në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit M.M nga Vushtrria, rruga ... me bazë juridike-Rimbursim dëmi.

Në seancën përgatitore të mbajtur me datë 14.03.2024, nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar edhe përkundër thirrjes së rregullt siç konstatohet nga fletëkthesa e datës 29.02.2024, po ashtu nuk ka prezantuar i padituri M.M, për të cilin nga fletëkthesa e datës 21.02.2024, konstatohet se i njëjti është i panjohur në adresën e dhënë si në padi, Vushtrria, rruga ..

Marr parasysh faktin se në seancë nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.66/18, me datë 14.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.